| | |
|---|---|
| **Buletini Nr. 246/ 2023, 23-09-2023** | **Parashikimi** nga 23-09-2023, ora 12:00 deri më 24-09-2023, ora 23:59. |

## ZJARRET NË PYJE

----------------------

Sot pasdite (e shtunë, dt.23) pritet nivel rreziku "I LARTË" në qarqet Kukës, Durrës, Tiranë, Fier dhe Berat, ndërsa nivel rreziku "I MODERUAR'' në të gjitha qarqet e tjera (siç tregohet në tabelë, respektivisht për secilin qark). Në shumicën e qarqeve me nivel rreziku "I MODERUAR" pritet nivel rreziku "I LARTË" vetëm në zona të lokalizuara, konkretisht: Dibër (VL), Elbasan (P), Korçë (Q), Vlorë (V) dhe Gjirokastër (V).
Nesër (e diel, dt.24) pritet nivel rreziku "I MODERUAR'' në qarkun e Korçës, ndërsa "S'KA RREZIK" në të gjitha qarqet e tjera.

## PARASHIKIMI METEO

----------------------

### RESHJET

Sot pasdite (e shtunë, dt.23) dhe nesër (e diel, dt.24) priten reshje mesatare deri lokalisht intensive në qarqet Shkodër dhe Lezhë, mesatare dhe të dobëta deri lokalisht mesatare në qarqet Kukës, Dibër, Durrës, Tiranë dhe Vlorë, ndërsa të dobëta në të gjitha qarqet e tjera (siç tregohet në tabelë, respektivisht për secilin qark). Në shumicën e qarqeve reshjet pritet të shoqërohen edhe me shtrëngata.

### TEMPERATURAT

Nesër (e diel, dt.24) temperaturat minimale dhe maksimale të ajrit pritet të arrijnë:
në bregdet: 20 / 24 °C
në vendet e ulëta: 20 / 25 °C
në vendet malore: 15 / 24 °C

### ERA

Sot pasdite (e shtunë, dt.23) era pritet të fryjë mesatare deri e fortë në të gjithë territorin, ndërsa nesër (e diel, dt.24) ajo pritet e lehtë deri mesatare, por në bregdet deri e fortë.

**BULETINI MBI RREZIQET NATYRORE** *(Bulletin on Natural Hazards)*
***Qendra Kombëtare për Parashikimin dhe Monitorimin e Rreziqeve Natyrore***
*Facebook page : Instituti i Gjeoshkencave, Webpage: www.geo.edu.al*

| **Buletini Nr. 246/ 2023, 23-09-2023** | **Parashikimi** nga 23-09-2023, ora 12:00 deri më 24-09-2023, ora 23:59. |
|---|---|

| ***NIVELET E RREZIKUT*** | **S'KA RREZIK** | **I ULËT** | **I MODERUAR** | **LARTË** |
|---|---|---|---|---|

## *PARASHIKIMI I DETAJUAR MBI RREZIQET NATYRORE (SOT DHE NESËR)*

| ***RREZIKU MAKSIMAL I QARKUT*** | ***Zjarre në pyje*** | ***Ngjarje Meteorologjike*** | | | ***Ngjarje Hidrologjike*** | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | ***Zjarret Mesatarja e qarkut*** | ***Reshje 24-orëshe Mesatarja e qarkut*** | ***Reshje 24-orëshe Maksimale të lokalizuara*** | ***Shtrëngata*** | ***Përmbytje të Shpejta*** | ***Përmbytje Lumenjsh*** | ***Rrëshqitje toke*** |
| **SHKODËR** | I MODERUAR | mesatare | intensive | | | | |
| **KUKËS** | I LARTË | mesatare | | | | | |
| **DIBËR** | I MODERUAR | të dobëta | mesatare | | | | |
| **LEZHË** | I MODERUAR | mesatare | intensive | | | | |
| **DURRËS** | I LARTË | mesatare | | | | | |
| **TIRANË** | I LARTË | të dobëta | mesatare | | | | |
| **ELBASAN** | I MODERUAR | të dobëta | | | | | |
| **FIER** | I LARTË | të dobëta | | | | | |
| **BERAT** | I LARTË | të dobëta | | | | | |
| **KORÇË** | I MODERUAR | të dobëta | | | | | |
| **VLORË** | I MODERUAR | të dobëta | mesatare | | | | |
| **GJIROKASTËR** | I MODERUAR | të dobëta | | | | | |

| | |
|---|---|
| **Buletini Nr. 246/ 2023, 23-09-2023** | **Parashikimi** nga 23-09-2023, ora 12:00 deri më 24-09-2023, ora 23:59. |

## LEGJENDA: *Reshjet 24-orëshe*

| **Niveli i Rrezikut** | ***Reshje shiu*** (mm / 24 orë) |
|---|---|
| S'KA RREZIK | të dobëta (0 – 15 mm / 24 orë)<br>Nuk priten fenomene hidro-meteorologjike problematike. |
| I ULËT | mesatare (15 – 45 mm / 24 orë)<br>Mundësi që të shfaqen fenomene hidro-meteorologjike problematike. |
| I MODERUAR | intensive (45 – 90 mm / 24 orë)<br>Moti parashikohet i rrezikshëm. Parashikohen fenomene të pazakonta hidro-meteorologjike. |
| I LARTË | shumë intensive (> 90 mm / 24 orë)<br>Moti është shumë i rrezikshëm. Parashikohen fenomene të pazakonshme hidro-meteorologjike mjaft intensive. |

## LEGJENDA: *Zjarre në pyje*

| | |
|---|---|
| S'KA RREZIK | Zjarret e mundshëm janë të kontrollueshëm lehtësisht. |
| ULËT | Barërat e thatë dhe pyjet mund të digjen lehtë. Flakët janë te mesme në pyje dhe të shpejta në zonat e ekspozuara. |
| I MODERUAR | Ndezja e zjarreve mund të ndodhë lehtë dhe me përhapje të shpejtë. Zjarret mund të jenë shumë të nxehtë, me kurora përhapje të vogla dhe të mesme. |
| I LARTË | Ndezja mund të shkaktohet edhe nga një shkëndijë. Zjarret janë shumë të nxehtë me përhapje shumë të shpejtë të flakëve si rrjedhim kontrolli i tyre është shumë i vështirë. |

## *SIMBOLE*

| | |
|---|---|
| | Shtrëngata: reshje mbi 20 mm/3orë. Moti mund të krijojë probleme të ndryshme |
| | Përmbytje urbane ose nga përrenjtë dhe lumenjtë e vegjël |
| | Përmbytje nga lumenjtë e mesëm dhe të mëdhenj |
| | Rrëshqitje toke |




***RREZIKU MAKSIMAL I QARKUT për sot dhe nesër, dt. 23 – 24.***